



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 08.10.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, në mbledhjen e datës 15 korrik dhe 8 tetor 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Ilir Beqaj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishte Z. Elton Haxhi, zëvendësministër në ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji parashikon krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare, e cila vjen si një koncept inovator për të adresuar nevojën e zhvillimit të krijimit të kapaciteteve për lehtësimin dhe realizimin e investimeve komplekse dhe me impakt social-ekonomik.

Korporata krijohet si shoqëri tregtare, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare, ku ministri përgjegjës për ekonominë është në cilësinë e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Korporatës. Institucionet financiare ndërkombëtare të zhvillimit mund të zotërojnë aksione të Korporatës.

Objekti i veprimtarisë së Korporatës është përmirësimi i menaxhimit të pronës publike, krijimi i pronave të reja, vënia në përdorim më eficient të pronave, përgatitja dhe zbatimi i projekteve të investimit dhe mobilizimi i kapitalit shtetëror ose privat, me qëllim kryerjen e investimeve në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Objektivi kryesor i aktiviteteve të Korporatës konsiston në krijimin e kushteve të favorshme për të rritur investimet në vend, diversifikimin e prodhimit dhe eksporteve, krijimin e ekspertizës për hartimin dhe zbatimin e projekteve komplekse të investimit, si dhe pajisjen e shtetit shqiptar me një kapacitet të munguar për realizimin e investimeve.

Referuar relacionit shoqërues, Qeveria shqiptare ka nevojë për një institucion që të ndërmarrë role të ndryshme lidhur me zhvillimin ekonomik. Një institucion i tillë kërkon kapacitetin për të transformuar ide dhe nisma investimesh në projekte të financueshme dhe tërheqjen e interesit nga investitorë cilësorë. Shumë projekte kërkojnë që qeveria të përdorë më mirë tokën ose asetet e tjera në pronësi të saj, të përgatisë projekte që, nëse vlerësohen të përshtatshme, mund të financohen. Për të mobilizuar kapitalin, institucioni në fjalë duhet të ketë kapacitetin për të strukturuar transaksione dhe të japë mbështetje financiare kur duhet për të reduktuar riskun tregtar.

Kjo strukturë nuk ekziston aktualisht në ekosistemin e agjencive në vend dhe as në sektorin privat. Është një njësi me thelbin e një fondi investimesh, por me qëllim të përcaktuar për zhvillimin ekonomik të vendit.

Ajo është e konceptuar për të qenë në gjendje të përfaqësojë qeverinë shqiptare në menaxhimin e aseteve strategjike dhe në maksimizimin e mobilizimit të kapitalit privat, të marrë përsipër shfaqjen e riskut në projektet strategjike dhe gjithashtu të bashkëpunojë me institucione financiare ndërkombëtare (IFIs) dhe sektorin privat.

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

Sipas relacionit shoqërues, ky projektligj krijon efekte financiare, pasi krijon strukturë të re shtetërore.

Për vitin 2019, nga buxheti i shtetit është parashikuar një fond buxhetor prej 368 milionë lekësh, në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si kapital fillestar për Korporatën.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

- ***Diskutimi në Komision***

Projektligji “Për korporatën e investimeve shqiptare”, është shqyrtuar nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datës 15 korrik 2019 dhe 8 tetor 2019.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për t’u përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin z. Elton Haxhi, zëvendësministër në ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

Relatori theksoi rëndësinë e projektligjit, duke shpjeguar thelbin e tij, krijimin e një instrumenti, i cili nuk ekziston aktualisht në eko sistemin e institucioneve të vendit. Krijimi i këtij instrumenti synon nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendit.

Ky institucion do të mundësojë zhvillimin e projekteve të mëdha, të cilat, lidhen me marrjen dhe vënien në shfrytëzim të aseteve shtetërore. Korporata e Investimeve synon të marrë përsipër të kthehet në një lloj fondi investimi, në drejtim të projekteve për të cilat shteti është i interesuar.

Gjithashtu, relatori shpjegoi se varianti fillestar i projektligjit është hartuar në bashkëpunim me një qendër të specializuar brenda universitetit të Harvard-it. Dy kanë qenë momentet kryesore të projektligjit, cilat janë debatuar fillimisht, bazuar në versionin fillestar: së pari, krijimi i një mjedisi gare sipas rregullave të konkurrimit në Shqipëri, dhe së dyti, cili do të jetë enti i pavarur që do të bëjë monitorimin e veprimtarisë së këtij institucioni.

Ky projektligj dhe problematikat e evidentuara janë diskutuar gjatë, duke u konsultuar edhe me Komisionin Evropian, me qëllim që versioni final i tij të jetë sa më pranë standardeve të qeverisjes së mirë, por edhe në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja.

Si rezultat i një pune të mirë, në bashkëpunim edhe me ministrinë, duke reflektuar edhe rekomandimet e Komisionit Evropian, është përgatitur një version integral, i përmirësuar i projektligjit.

Diskutimet e anëtarëve të Komisionit dhe pyetjet drejtuar përfaqësuesve të ministrisë, u përqendruan në çështje të tilla si; forma, mënyra e administrimit dhe funksionimit të Korporatës së Investimeve; organet drejtuese të saj; mënyra e përdorimit të pronave shtetërore, aktualisht dhe si do të bëhet ajo nga Korporata; përdorimi dhe kontrolli i fondeve; eksperiencat dhe modele të ngjashme ndërkombëtare; kriteret e përzgjedhjes së pronave shtetërore që do të përdoren nga Korporata dhe procesin e konsultimit me grupet e interesit.

Përfaqësuesit e ministrisë u shprehën se projektligji synon krijimin e një korporate, në formën e një shoqërie aksionare, ku aksionar i vetëm do të jetë shteti shqiptar, i përfaqësuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Projektligji përcakton mënyrën e administrimit dhe funksionimit të Korporatës, të organeve të saj drejtuese, objektin dhe funksionet e saj, përdorimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të shpenzuara nga Korporata, si dhe mekanizma të tjerë rregullues apo mbikëqyrës.

Mbikëqyrja e veprimtarisë së Korporatës do të realizohet nëpërmjet përbërjes së Këshillit Mbikëqyrës, i cili është një organ, në shumicën e tij, i pavarur nga qeveria, si dhe nga Bordi Këshillimor, edhe ky i pavarur nga qeveria. Përbërja dhe mënyra e krijimit dhe funksionimit të këtyre këshillave do të mundësojë realizimin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së Korporatës, nga njëra anë, por edhe do të sigurojë pavarësinë e vendimmartjes së saj ndaj organizmave shtetërorë.

Korporata do të ketë si kapital fillestar, përveç kontributit monetar, në vlerën 3 milion euro, të parashikuara nga buxheti i shtetit, edhe një sasi të kufizuar pronash shtetërore të cilat më tej do të zhvillohen nëpërmjet projekteve dhe studimeve të fisibilitetit. Natyra e këtyre pronave, është e tillë që kërkon menaxhimin nga një korporatë, e cila do të ketë të gjitha kapacitetet e nevojshme për një vlerësim objektiv edhe në aspektin e përfitueshmërisë.

Kriteret mbi të cilat do të vlerësohen pronat që do të përdoren nga Korporata janë përcaktuar në një dokument analitik, i cili nuk është një studim i mirëfilltë fisibiliteti, por bën një analizë të përshtatshmërisë së pronave, për efekt të përcaktimit të këtyre kriterëve. Kriteret e përzgjedhjes do të jenë madhësia e pronës, pastërtia e saj, pra prona të mos ketë problematika pronësie, si dhe largësia nga rrjeti infra-strukturor. Ndërsa, lista e pronave do të përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Modeli i Korporatës është marrë nga modeli i suksesshëm i korporatës së Jordanisë, krijimi dhe funksionimi i së cilës, ka mundësuar zhvillimin rrënjësor të një zone të pazhvilluar, në një motor gjenerues të zhvillimit ekonomik të atij vendi.

- ***Ndryshime të projektaktit dhe rekomandime***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi versionin integral të projektligjit, në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni, vendosi t'i rekomandojë Komisionit Përgjegjës rishikimin e neneve 12 dhe 13 të projektligjit, që lidhen me përbërjen dhe funksionet e organeve drejtuese të Korporatës, konkretisht, Asamblesë dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Në nenin 12, “Asambleja e Përgjithshme”, përbërja e Asamblesë, fillimisht, vetëm nga ministri i ekonomisë, në cilësinë e aksionarit që përfaqëson interesat e pronarit shtet dhe kompetenca e tij për të miratuar statutin e Korporatës, e bën të dobët këtë organ.

Për këtë arsye, sugjerohet që, nëse gjendet hapësirë ligjore, miratimi i statutit të korporatës të bëhet nga Këshilli i Ministrave.

Edhe në nenin 13, “Këshilli Mbikëqyrës”, emërimi i anëtarëve të Këshillit nga Asambleja e Përgjithshme, pra nga ministri përgjegjës për ekonominë, përbën një tjetër pikë të dobët, e cila mund të cenojë pavarësinë e këtij organi.

Për këtë qëllim Komisioni i sugjeron komisionit përgjegjës që nëse gjendet hapësirë ligjore, të paktën, emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të bëhet nga Këshilli i Ministrave.

RELATOR

KRYETAR

Ilir BEQAJ

Niko PELESHI